

Zyrtarët e Lidhjes Demokratike, e ata të Partisë Demokratike, vazhdojnë të kenë qëndrime të ndryshme për postin e kryeministrit. Burime të Televizionit Rrokum brenda grupeve punuese për ndarjen e resorëve dhe planin qeverisës, thonë se posti i kryeministrit nuk është definitiv.

Sipas këtij burimi, pozita e të parit të qeverisë po diskutohet. Dhe, nëse kryeministër do të jetë kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, atëherë PDK do të ketë tetë ministri, ndërsa LDK shtatë. Katër ministri do t'ju jepen partive minoritare.

Por, në rast se PDK nuk lëshon pe dhe vazhdon të insistoje që Hashim Thaçi të mbetet kryeministër, atëherë ai do të drejtojë Qeverinë edhe për dy vjetët e ardhshme, derisa presidentes aktuale, Atifete Jahjaga, t'i kalojë mandati. Pastaj, më 2016 Thaçi kandidon për postin e presidentit, e në karrigen e kryeministrit vendoset Isa Mustafa apo Lutfi Haziri.

Rrokum ka siguruar edhe disa nga emrat e mundshëm për ministra, të cilët janë diskutuar në takimin e fundit të grupit punues.

Disa prej ministrave të ardhshëm të qeverisjes PDK-LDK janë: Bardhyl Meta (ministër i Zhvillimit Ekonomik), Sadri Ferati (ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale), Valon Murtezaj (ministër i Punëve të Jashtme), Skender Hyseni (ministër për Integritet Evropian).

Grupi punues ka mbetur të vendos ndërmjet dy emrave për ministër të Shëndetësisë - Bekim Haxhiun apo Bajram Rexhepin.

Blerand Stavileci do të mbetet ministër i Bujqësisë ose i Administratës Publike. Memli Krasniqi, aktualisht ministër i Kulturës, ka mundësi të mbetet aty ku është, megjithëse kjo Ministri mund të jetë një nga katër ministratë që mund t'ju takojë minoriteteve.

Agim Çeku do vazhdojë të mbetet ministër i Forcës së Sigurisë. Ndërsa, Ministria e Arsimit po synohet t'i besohet Ferid Aganit - kryetar i Partisë së Drejtësisë.

Grupet punuese do të mblidhen të hënën. Rrokum po ashtu mëson se seanca për përmbylljen e konstituimit të Kuvendit nuk do të mbahet mbajt deri në fund të javës që vjen, përkatësisht deri në ndarjen e tanë resorëve ministrorë. /Rrokum/

[KUSH JANË MINISTRAT E ARDHSHËM](#) by [RrokumTelevision](#)